



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 1477	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2	
Data / Datum / Date 23.06.2025		Pojë / Poë

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dhe nenit 27 paragrafi 2 të Statutit të UHZ-së, Këshilli Drejtues i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me 18.06.2025, mori vendim nr. 1457 dt. 20.06.2025, të shpallë Konkurs për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka".

KONKURSIT

për zgjedhjen e Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë

I. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencore dhe të ketë gradën më së paku të profesorit të asocuar;
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

II. Procedura e përzgjedhjes:

1. Konkurimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm;
2. Komisioni Profesional i zgjedhur nga Senati propozon listën prej kandidatëve të zgjedhur me shumicë votash, për t'u zgjedhur nga Këshilli Drejtues;
3. Këshilli Drejtues i interviston kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista secili kandidatë prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese;
4. Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozura nga Komisioni Profesional prej pesë (5) anëtarëve të cilin komision e formon Senati;
5. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikoj nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs;
6. Këshilli Drejtues ka të drejt të refuzoj listën e kandidatëve të propozuar nga komisioni profesional duke e arsyetuar atë;
7. Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit, për shkak të konfliktit të interesit aplikohet ligji në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
8. Rektori zgjedhet me 2/3 e votave (shumicë e anëtarëve të përgjithshëm) në pajtim me dispozitat e Statutit të UHZ. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy (2) kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Në rast se asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton 2/3 e votave as në radhën e dytë të votimit atëherë përsëritet konkursi;
9. Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë prej katër vitesh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Kandidatët së bashku me kërkesë duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër;
- Çertifikatën ose ekstraktin e lindjes;
- Dokumentin e identifikimit;
- Kopjet e diplomave apo dëshminë mbi përfundimin e studimeve pasuniversitare, sipas rastit (studimet jashtë vendit) dhe dëshminë e nostrifikimit të diplomave;
- Të gjitha kopjet e dokumenteve duhet të jenë të noterizuara;
- Vendimin/ çertifikatën apo ekuivalente të titullit akademik;
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale në arsimin e lartë;
- Dëshminë që nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe që nuk ka aktakuzë të ngritur.
- Vizionin mbi menaxhimin e universitetit.

Të drejtë aplikim kanë të gjithë kandidatët pa asnjë lloj diskriminimi, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore të parapara për këtë pozitë.

Dokumentacioni i kompletuar në kopje fizike duhet të dorëzohet çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në orën 16:00, në zyrën e arkivit në objektin e Rektoratit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rr. UQK-së 30000 – Pejë, dhe duhet t'i adresohet Komisionit Profesional të Senatit të UHZ-së.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit në ueb-faqen zyrtare të universitetit: www.unhz.eu, përkatësisht nga data 23.06.2025 deri më 11.07.2025, në ora 16.00.